



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .11.2022

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga Ermeta Shevroja, gazetare pranë televizionit ABC

Znj. Ermeta Shevroja

Email- ernetashevroja@gmail.com

TIRANË

E nderuar znj. Shevroja,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, email i datës 14.11.2022 dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) me anë të së cilës kërkon;

- o informacion nëse institucioni juaj ka nisur verifikimet për dyshimet për politikanin I.M, nëse ka bashkëpunuar me Sigurimin e Shtetit me hyrjen në fuqi të ligjit dhe heqjen e pengesës,
- o a ka dhe politikanë të tjerë për të cilët institucioni juaj ka indicie, të ardhura nga institucione apo individë, se kanë qenë bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit, ju informojmë si më poshtë:

Së pari : Ligji nr. 45/2015, përcakton qartë subjektet kërkues që mund të kenë qasje në informacion, *(kur ai ka cilësinë e të prekurit, palës së tretë, studiues, bashkëpunëtorit apo të favorizuarit të ish-Sigurimit të Shtetit, i afërm e familjar i tyre si dhe institucione për verifikim zyrtarësh, kandidat për deputet/kryetar bashkie)*, objektin, qëllimin dhe përdorimin e informacionit, të drejtat e kërkuesve, mbrojtjen e palëve të prekura apo të tretëve, kriteret e përdorimit të informacionit si edhe dispozitat procedurale për mënyrën se si të aksesohet informacioni, sipas dispozitave njohëse dhe kufizuese të ligjit nr. 45/2015.

Çdo person gëzon të drejtën të njihet dhe të kërkojë një kopje të dokumenteve që ish Sigurimi i Shtetit ka krijuar **për atë personalisht dhe të afërmit e tij**,

Në zbatim të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, Autoriteti, nuk e nis procedurën e verifikimit të pastërtisë së figurës kryesisht ose me inisiativën e tij, por vetëm pasi të bëhet kërkesa nga institucionet kushtetuese, autoritetet publike nga subjektet politike/kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë për qëllime të përmbushjes së funksioneve të tij, apo çdo individ, dhe në të gjitha këto raste Autoriteti, ka detyrimin që të kryejë verifikimin dhe të informojë kërkuesin për rezultatin e kërkimit.

Sa më sipër, Autoriteti, në mungesë të një kërkesë të re të paraqitur nga vetë shtetasi apo zyrtari në cilësinë e kërkuesit apo të një kërkesë të re nga institucionet që më parë kanë kërkuar verifikimin e zyrtarit në fjalë, nuk mund të vihet në lëvizje.

Riverifikimi i figurës së zyrtarëve, mund të kryhet vetëm në bazë të kërkesave të reja të paraqitura. Kjo do të thotë që edhe pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore, Autoriteti do vijojë të verifikojë cdo figurë vetëm në bazë të kërkesave të paraqitura nga subjektet kërkuese të interesuara (individë, institucione kushtetuese, autoritete publike apo subjekte politike pjesmarrëse në zgjedhje).

Gjithashtu, Autoriteti është i gatshëm të angazhohet dhe të bashkëpunojë me të gjithë institucionet, që me rastin e ndryshimeve ligjore të vlerësojnë nëse janë në rastin që të kërkojnë riverifikimin e figurës së kandidatëve për të cilët është hequr tashmë pengesa ligjore (Çertifikata e pastërtisë së figurës dhënë nga komisionet e mëparshme Mezini Bezhani).

Sa i takon pyetjes së dytë: Në cdo rast që pranë institucionit vjen një informacion apo indicie për figura të ndryshme të jetës politike, Autoriteti i orienton të gjithë të interesuarit të ndjekin rrugën ligjore për informim, bazuar në ligjin nr. 45/2015, i ndryshuar, duke plotësuar formularin e miratuar nga Autoriteti për njohje me dokumentin apo informacionin në rrugë ligjore. Deri tani nga asnjë i interesuar nuk është ndjekur rruga ligjore për sa më sipër.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

**Në mungesë dhe me Urdhër
Drejtori i Informacionit
Selami Zalli**

Konceptoi: L. Cocoli
Datë: 22.11.2022